

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“Ortak Partners” SHPK

Sot ne daten 21/02/2025, ortaket themelues :

Julinda Myftiu, e datelindjes 24.08.1987, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, e pajisur me leternjoftimin me nr.personal I75824006T.

Indrit Myftiu, i datelindjes 07.04.1977, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, i pajisur me leternjoftimin me nr.personal H70407035H.

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ‘ dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ‘Per qendren kombetare te regjistrimit ‘ kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “Ortak Partners” SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet “Ortak Partners” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Shetitorja “Kavaljon” afer ish fabrikes se qelqit,nr. pasurie 9/192-B, ZK 8552, Kavaje. Shoqeria mund te krijoje dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: “Studio projektimi, projektim arktekonik, inxhinierik, studime urbanistike, projektim vepra inxhinierike dhe arti, ndërtime civile dhe industriale, banesa, vepra të karakterit ndërtimor me konstruksion betoni apo hekuri, marrja e përfaqësisë në fushën e ndërtimit, projektim dhe zbatim punimesh ndërtimi, dizenjim urbanistik, konsultim në aktivitetet e ndërtimit, gërmime

dheu, aktivitet i gurore, pastrimi në ambjente publike dhe private, izolime, instalim impiante elektrike dhe hidraulike, restaurime dhe mirëmbajtje të pasurive të paluajtshme në pronësi apo të marra nën kujdes, impiante teknologjike, vepra të inxhinierisë së natyrës, aparatura strukturore speciale, barriera dhe mbrojtëse rrugore, struktura të parafabrikuara prej betoni, impiante për përpunimin dhe rekuperimin e mbeturinave, pastrim të sipërfaqeve ujore, detare, liqenore, lumore, linja dhe impiante telefonike, interneti, të rrjetit të telekomunikimit dhe transmetimit, komponente strukturore me përbërje hekuri dhe metali, matje topografike, impiante depurimi, asgjësimi i veprave të ndryshme, gjelbërim dhe rregullim territori, gërmime arkeologjike, ndërtim të dyshemesë dhe strukturave speciale të sipërme, impiante 2 termike dhe të kondicionimit, sisteme kundra zhurmës për infrastrukturën e pajisjeve të lëvizshme, rikonstruktime, lotizime, prodhim materiale të ndërtimit dhe të gjitha nëndegëzimet dhe tregtimi i tyre, aktivitet imobiliar, marrja e licencave të ndryshme në çdo aktivitet të ndërtimit apo lëndës së ndërtimit, import-eksport i materiale të ndërtimit, mjeteve motorike të rënda të përdorshme në ndërtim apo në industri të tjera të biznesit, pjesë këmbimi për to, makinerive të përdorshme në ndërtim dhe tregtimi apo dhënia me qera apo tituj të tjerë tek të tretët, shërbimi i mirëmbajtjes dhe pjesë këmbimi për këto mjete motorike dhe makineri, materialeve të ndërtimit, mallrave të përgjithshme pakufizim që kërkohen në tregun e lirë, tregtimi me pakicë i karburantit dhe nënprodukteve të tij, përdorim direkt ose indirekt i veprave të ndërtuara ose të blera të impianteve dhe të shërbimeve të tyre, tregtimi me shumicë e pakicë i materiale të të gjitha kategorive dhe nëndegëzime të tyre që përdoren në ndërtim, makineri pajisje të përdorshme në industrinë e ndërtimit, biznese profesionale mbështetëse, biznese shërbimi, barerestorantehotele-shërbime, materiale elektroshtëpiake, mallrave dhe sendeve që kërkohen në treg dhe ku shoqëria parapëlqen të investojë dhe ushtrojë veprimtari tregtare, shitblerje, depozitim dhe marrje të përfaqësisë për materiale, makineri dhe prodhime të tjera në përgjithësi të lidhura me industrinë e ndërtimit, e pajisjeve industriale dhe të ngjashme me to, zhvillimi i aktivitetit të turizmit në çdo fushë, promovimi, shfrytëzimi i kapacitetit turistik dhe argëtues, agjensi komisionere, punësimi, transporti të çdo lloji për interesin e vet apo të të tretëve, spedicioni, administrimi dhe aktivitet tregtar në gamën e shërbimeve bare-restorantehotele, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, operacione që lidhen me pasuri të paluajtshme/luajtshme, të blejë e të shesë, marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri tregtare, ente, konsorciume, shoqëri të thjeshta, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të ngjashëm me shoqërinë, të japë garanci, dorëzani, të marrë hua dhe ofrojë garanci pasurore në favor të të tretëve të jetë palë dhe të ofrojë shërbime, produkte, nëpërmjet të gjitha formave të kontraktimit apo prokurimit publik, marrëveshjeve apo tratativave tregtare apo/dhe me karakter civil, etj. Ushtimi i çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj.”

Konsulence dhe ndërmjetësim për shitjen e pasurive të paluajtshme (shitje, blerje, qira).

Neni 4

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë “Ortak Partners” Shpk do të jetë 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 2 kuota dhe zoterohet ne masen 81% nga ortaku INDRIT MYFTIU dhe 19% nga ortaku JULINDA MYFTIU.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar .

Neni 6

Organet e shoqerise

1.Asambleja e pergjithshme

2.Administratori

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete Znj. Julinda Myftiu, e datelindjes 24.08.1987, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, e pajisur me leternjoftimin me nr.personal I75824006T e cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne do moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht që ne mbledhje të marrin pjesë ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtone apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c) me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",

d) me vendim te giykates,

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi I shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10


Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershtohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

JULINDA MYFTIU



INDRIT MYFTIU

